



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 12740 Prot

Tiranë, më 14.7.2021

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele brenda sistemit doganor)

Drejtuar: DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE
Për publikim: DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE
INTERGRIMIT EUROPIAN

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në mbështetje të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar, në zbatim të pikave 5 dhe 6 të nenit 15 të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuarm, të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionet:

2 pozicione vakant Doganier, Zyra Doganore Tiranë, Sektori i Operacioneve Doganore, Dega Doganore Tiranë.

Kategoria e pagës IV-a,

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

Doganieri i zyrës Doganore Tiranë përgjigjet tek përgjesjesi i zyrës së operacioneve doganore dhe në raste të veçanta edhe tek Kryetari i Degës Doganore, për kryerjen e punës në zyrën e operacioneve doganore, ku përfshihen operacionet doganore si dhe kontrollet dokumentare dhe/ose fizike, kontrolle lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen etj.

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere:

Kriteret minimale:

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës

- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

Kriteret e veçanta:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit të parë dhe “bachelor” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat Ekonomike, Juridike, Natyrore, Politeknike, Akademi Ushtarake Policore,

Për të qenë pjesëmarrës në konkurim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 13.07.2021 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

Fusha e Njohurive:

1. Ligji nr102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.
4. Ligji nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronesine Industriale”, i ndryshuar.
5. Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar.
6. Ligji nr. 9367, datë 07.07.2015 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
7. Urdhëri nr. 146, datë 07.05.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “ Për miratimin e Rregullores së Brendshme “ Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore:
8. Urdhëri nr. 123, datë 09.11.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr. 90, datë 18.11.2014 “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar.

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë ekzekutive”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al".

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli

